



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS KOSOVO DOCTORS CHAMBER LEKARSKA KOMORA KOSOVA			
Njësi: Unit:	ADM	Nr. Prot.:	86/2023
Jedinita:		Br. Prot.:	
Nr. i faqeve: No. of pages:	-02-	Data:	13.11.2023
Br. stranica:		Datum:	
Pylshëdhëja			

ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS

KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Në mbështetje të Nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, si dhe Nenit 4 dhe 5 të Udhëzimit Administrativ 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Aneksit 1 pika 5 e Rregullores mbi Organizimin dhe Sistematizimin e vendeve të punës në Shërbimin Profesional të OMK-së, Oda e Mjekëve të Kosovës, shpall këtë:

KONKURS I BRENDSHËM

Titulli i Punës: ZYRTAR/E I/E FINANCAVE OMK

Numri i pozitave: 1 (një vend pune),

Nr. ref: 09/2023

Kohëzgjatja e Kontratës: Kohë të pacaktuar

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Regjistrimi i faturave të blerjeve dhe shitjeve në përputhje me standardet e kontabilitetit dhe ligjeve të tjera të zbatueshme;
- Mirëmbajtja e dokumentacionit financiar në bazë të kërkesave ligjore;
- Regjistrimi dhe konsolidimi i llogarive bankare;
- Përgatitja e autorizimeve dhe dokumentacionit përkatës për procesim të pagesave;
- Përgatitja dhe menaxhimi i llogarive të arkëtueshme dhe të pagueshme;
- Mbajtja e evidencës së punës ditore/mujore për punëtorët;
- Përgatitja e listës së pagave;
- Përgatitjen e pasqyrave financiare;
- Deklarimi i tatimeve;
- Kontrollimi dhe barazimi i listave të pjesëmarrjes mujore nga ana e komisioneve me financa;
- Është përgjegjës për punë dhe detyra të punës që i janë përcaktuar apo i përcakton e i përgjigjet Udhëheqësit të financave.

Mbikëqyrja e drejtpërdrejtë: Udhëheqësit të Zyres për Administratë dhe Financa

Aftësitë/përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen:

- Diplomë të nivelit universitar në ekonomi, financa. Diploma post diplomike e nivelit master është përparësi;
- Tri (3) vjet përvojë pune në financa dhe kontabilitet dhe në punët dhe detyrat e njëjta;
- Aftësia organizative;

- Aftësia për kryerjen e punëve;
- Të ketë integritet të lartë moral dhe t'i përmbahet standardeve të larta të etikës;
- Aftësi të shkëlqyeshme ndër personale dhe aftësi në zgjidhjen e konflikteve;
- Njohuri të rrjedhshme në të folur dhe në të shkruar në njërën nga gjuhët zyrtare, njohja e gjuhës angleze është përparësi;
- Njohuri të shkëlqyeshme në aplikacionet e Microsoft Office. Njohja e programeve të të menaxhimit të financave është përparësi.

Paraqitja e kërkesave:

Shënim: Procedura e konkurrimit është e hapur për nëpunësit e OMK-së, të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit për avancim. Oda e Mjekëve të Kosovës, ofron mundësi të barabarta të avancimit për të gjithë nëpunësit ekzistues brenda Odës.

Konkursi i brendshëm mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në ueb faqen e OMK-së, dhe në tabelën e shpalljeve, duke filluar nga data 13.11.2023 deri më datën 29.11.2023, ora 16:00, që konsiderohet ditë e fundit e mbylljes së konkursit.

Formularët për aplikim mund të shkarkohen nga ueb faqja e OMK-së, www.omk-rks.org dhe të gjitha aplikacionet e plotësuara së bashku me kopjen e letërnjoftimit, kopjet e dëshmimeve për kualifikimet e nevojshme arsimore, përvojën e punës, kurset e ndjekura, referencat si dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme të kërkuara sipas kushteve të konkursit, mund të dorëzohen:

- Përmes e-mail adresës info@omk-rks.org apo
- Përmes postës në adresën “Instituti A” QKUK, kati II, 10 000 Prishtinë, RKS

Në subject të email-it të ceket pozita për të cilën aplikoni dhe emri, mbiemri juaj!

Aplikacionet e dërguara pas afatit të paraparë dhe aplikacionet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Për informata shtesë mund të kontaktoni në numrat e telefonit: **049/872-300** apo **038/544-872**.